

SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS-KANALIZIME DIBËR SH.A

SEKTORI I BURIMEVE NJERËZORE

SHPALLJE PËR VENDE TË LIRA PUNE

Bazuar ne Ligjin 7961, date 12.07.1995 “Kodi i Punes i Republikes se Shqiperise”, i ndryshuar, mbështetur në Ligjin nr.9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqërite Tregtare” të ndryshuar, Vendimit te Këshillit te Ministrave nr. 302, datë 11.05.2022 “Politikat Kombëtare për Riorganizimin e Sektorit te Furnizimit me Ujë të Largimit të Ujrave te Ndotura”, Statutin Shoqërisë me nr.1861 Prot. datë 01.09.2022, Rregullorës së brendëshme të Shoqërisë, Marrveshjes për krijimin e subjektit të kompetencave të përbashkëta të Ujësjiellës Kanalizime Dibër sha, datë 22.07.2022, shpallen procedurat e konkurimit për vend të lirë pune:

1(një) Grup Operimi Komandues Linjash, Mirmbajtës Linje Kryesore, Njësia Mat

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore

Grup Operimi Komandues Linjash, Mirëmbajtës Linje Kryesore i Njesisë varen nga ana administrative nga Përgjegjësi i Administratës së Njesisë përkatëse dhe nga ana funksionale nga Drejtori i Drejtorisë Teknike.

Grup Operimi Komandues Linjash, Mirëmbajtës Linje Kryesore kanë këto detyra;

- Kryerjen me përpikmëri të detyrave të caktuara nga Dispeçeri në Drejtorinë Teknike pranë U.K. Dibër Sh.a.
- Të kontrolloje dhe të raportojë, çdo ditë, tek Dispeçeri në Drejtorinë Teknike pranë U.K. Dibër Sh.a. për gjendjen e linjave që ka nën kontroll.
- Të evidentojë çdo humbje ose problem në linjën që mbulon ose në aksesore (*saraçineska, ajrues, shkarkues, etj.*) dhe ta paraqesë atë me shkrim pranë Dispeçerit në Drejtorinë Teknike pranë U.K. Dibër Sh.a.
- Për çdo defekt që ndodh merr pjesë në riparimin e tij si dhe mban proces-verbalin përkatës për çdo punim.
- Nuk lejon të riparohen defektet jashtë kushteve teknike e të sigurimit teknik. Për çdo punim jashtë kushteve teknike duhet të njoftojë menjëherë Dispeçerin në Drejtorinë Teknike pranë U.K. Dibër Sh.a.
- Bën evidentimin e lidhjeve dhe ndërhyrjeve të paligjshme që mund të bëhen në këto linja.
- Merr pjesë në grupet e punës për ndërprerjen e lidhjeve të paligjshme të bëra në pjesën e linjës që ai mbulon.
- Në raste avarie kryen manovrimet e duhura për të bërë punimet e nevojshme.

- Përgjigjet për kryerjen e shërbimit të manovrimit sipas grafikut të miratuar. Është përgjegjës për çdo moszbatim të grafikut ose për ndryshimin e tij pa miratimin e Dispeçerit në Drejtorinë Teknike pranë U.K. Dibër Sh.a.
- Në asnjë rast nuk largohet nga vendi i punës pa u zëvendësuar dhe pa marrë pëlqimin e Dispeçerit në Drejtorinë Teknike pranë U.K. Dibër Sh.a. Për arsye madhore (*sëmundje apo arsye të tjera të justifikuara*) mund të largohet nga puna me miratim të Dispeçerit në Drejtorinë Teknike pranë U.K. Dibër Sh.a., i cili merr masa për zëvendësim e tij.
- Marrja në dorëzim e turnit bëhet vetëm me proces-verbal të rregullt, ku pasqyrohen këto procese pune:
 - a. Kontrolli i prurjes së ujit
 - b. Gjendja e saraçineskave, etj.
- Gjatë marrjes së turnit në dorëzim Komanduesi duhet të njihet me urdhrat e dhënë nga Dispeçeri në Drejtorinë Teknike pranë U.K. Dibër Sh.a. gjatë periudhës që ai nuk ka qenë në detyrë dhe duhet t'i zbatojë ato me korrektësi.
- Është i detyruar të paraqitet në vendin e punës 15 minuta përpara marrjes së detyrës nga orari i punës së caktuar nga Shoqëria.
- Mban përgjegjësi dhe përgjigjet për pastërtinë e ambienteve të punës dhe për mos plotësimin dhe ruajtjen me seriozitet të librit të shërbimit.
- Mban përgjegjësi, sipas shkallës së dëmit dhe rrezikshmërisë, për të gjitha veprimet e kryera në kundërshtim me Urdhrat e dhënë nga Dispeçeri në Drejtorinë Teknike pranë U.K. Dibër Sh.a., apo për mos realizimin në afat dhe me cilësi të detyrave të ngarkuara.
- Bën të gjitha manovrimet e caktuara për punimin normal të linjave.
- Bashkëpunon me Drejtorinë Teknike pranë U.K. Dibër Sh.a. dhe mbështet grupet e tyre të punës që dërgohen për zgjidhjen e problemeve teknike në linjat e transmetimit.
- Mirëmbajtjen e rrjetit kryesor të furnizimit me ujë të pijshëm.
- Të kontrollojë linjën e tubacionit sipas zonës që mbulon.
- Të njoftojnë Dispeçeri në Drejtorinë Teknike pranë U.K. Dibër Sh.a. për problemet që mund të ndodhin në linjën kryesore, sipas zonës që mbulon.
- Të respektojnë me përgjegjshmëri të plotë regjimin/orarin e furnizimit me ujë të pijshëm, konsumatorëve, për zonën që mbulojnë.
- Të njohin vend qëndrimin e zakonshëm të konsumatorëve, të zonës së tyre të mbulimit, mënyrat e furnizimit me ujë të pijshëm dhe të përcaktojnë saktësisht sasinë e ujit të pijshëm që u nevojitet atyre.
- **Gjithashtu mban përgjegjësi për veprimet dhe mosveprimet që pengojnë plotësimin e detyrave të përcaktuara në këtë rregullore.**
- Mban përgjegjësi ligjore administrative dhe penale për defektet/problemet që ndodhin shkaktuar me fajin e tij.
- Zbaton disiplinën në punë dhe detyrat e përcaktuara në këtë rregullore.
- Ka detyrimin të përmbushë çdo urdhër tjetër apo porosi (*me shkrim dhe me gojë*) të eprorëve, që nuk përfshihet në pikat më lart, kur nuk përbëjnë shkelje ligjore, dhe që nuk çenojnë dinjitetin e punonjësit.

Kandidatet duhet të plotesojnë kërkesat e posaçme si vijon:

- ✓ Të jenë shtetas shqiptarë;
- ✓ Të kenë përfunduar arsimin e detyrueshëm (9-vjeçar) ose arsimin e mesëm;
- ✓ Të kenë eksperiencë pune në profesion, e preferueshme;
- ✓ Të jenë në gjendje të mirë shëndetësore dhe të aftë fizikisht për të përmbushur detyrat dhe përgjegjësitë e pozicionit përkatës.

DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

1. Curriculum Vitae (CV);
2. Fotokopje të kartës së identitetit;
3. Fotokopje të librezës së Punës (nëse disponon);
4. Çertifikatë personale;
5. Çertifikatë e gjendjes familjare;
6. Diplome shkolle (e noterizuar);
7. Listë notash (e noterizuar);
8. Dokumente që vërtetojnë kualifikime ose eksperiencë pune (nëse ka);
9. Dëshmi Penaliteti;
10. Vërtetim i Gjendjes Gjyqësore;
11. Vërtetim prokurorie;
12. Saktësim adrese nga Bashkia;
13. Raport Mjekoligjor (Aftësi në punë);
14. Foto të vogla dy (2 copë), foto e madhe një (1 copë).

Kandidatet do të vleresohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar dhe nevojave të institucionit.

Në përfundim të procesit të vlerësimit, Shoqërisa Rajonale Ujësjiellës-Kanalizime Dibër sh.a, përmes Drejtorisë së Shërbimeve dhe Sektorit Juridik dhe Burimeve Njerëzore, do të shpallë fituesin në portalin e “ Shërbimit Kombëtar të Punësimit”.

Kandidatet jo fitues kanë të drejtë të paraqesin ankesë me shkrim pranë Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës-Kanalizime Dibër sh.a, brenda 3 (tre) ditëve nga data e shpalljes së fituesit. Ankesa protokollohet dhe shqyrtohet nga Sektori Juridik, në përputhje me aktet e brendshme dhe legjislacionin në fuqi.